



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 932/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Ymer Hoxha dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega Prishtinë paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Prishtinë, për shkak të mospërputhjes së rezultateve në FPR dhe atyre përfundimtare në Vendvotimet (VV) në Komunën e Prishtinës, në seancën e panelit të mbajtur me 18.11.2013, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) në Prishtinë

### Arsyetim

PZAP-i, më datën 15.11.2013, ka pranuar një ankesë nga LVV, në të cilën theksohet se si rrjedhojë e publikimit të rezultateve përfundimtare të publikuara me datën 14 Nëntor 2013, nga KQZ, për zgjedhjet e kryetarëve të komunave, LVV ka krahasuar të dhënat që janë përpunuar nga QNR-ja dhe janë publikuar nga KQZ-ja, ku disa kuti të votimit nuk janë të përputhshme të dhënat e publikuara me të dhënat e FPR-ve të atyre VV. Në këtë drejtim në VV 1902e/01R, kandidati Valon Murati nga subjekti politik Lëvizja për Bashkim ka 3 vota sipas FRP-së, ndërsa në rezultatet e publikuara figuron që i njëjti kandidat t'i ketë 8 vota, në VV 1919e/04R kandidati për kryetar komune Visar Arifaj nga subjekti politik Partia e Fortë i ka 5 vota sipas të dhënave në FPR, ndërsa sipas të dhënave përfundimtare i ka 3 vota, në VV1920e/03R kandidati për kryetar komune Shpend Ahmet nga LVV i ka 119 vota sipas FPR-së, ndërsa në të dhënat përfundimtare i ka 120, në po të njëjtin VV 1920e/03R, kandidati i LDK-së, Isa Mustafa i ka 185 vota në FPR, ndërsa në publikimin e të dhënave përfundimtare i ka 228, në VV 1934e/01R kandidati i LDK-së sipas FPR i ka 235 ndërsa sipas të dhënave përfundimtare 237, kandidati i AKR-së sipas FPR-së i ka 29 vota ndërsa sipas të dhënave përfundimtare i ka 28 vota, kandidati i PDK-së, sipas FPR-së i ka 77 vota, ndërsa sipas të dhënave përfundimtare 76, kandidati i PF-së, ka 0 vota sipas FPR-së, ndërsa sipas të dhënave përfundimtare ka 1 votë.

Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur ankesës si dëshmi FPR-të nga VV, ku sipas tyre janë evidentuar dallimet në të dhënat e publikuara.

PZAP-i, më datë 16.10.2013, në bazë të nenit 117.2 dhe 117.4, të LZP-së, dhe neni 12 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka kërkuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), materialin zgjedhor si: Lista përfundimtare e votuesve (LPV), Formularët e Përputhjes së Rezultateve (FPR), Formularin e Rezultateve për Kandidat (FRK), dhe Librin e Vërejtjeve (LV), për VV 1711C/01R, në të njëjtën datë PZAP-i, pranoi materialin zgjedhor nga KQZ, si dhe ka shqyrtuar dhe hetuar materialin zgjedhor dhe pretendimet ankimore, provat që gjendet në shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të secilës provë veç e veç si dhe duke u bazuar në rezultatin e tërësishëm të provave të administruara ka gjetur se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore se ka mospërputhje të rezultateve në mes të atyre të publikuara më herët dhe rezultateve përfundimtare është e natyrshme, sepse rezultatet preliminare janë fleksibile dhe të ndryshueshme në çdo moment, që nënkupton se këto rezultate publikohen, për pa u proceduar të gjitha fletëvotimet .Ndërsa rezultati përfundimtar është publikuar me 14.11.2013, nga KQZ-ja, të cilat rezultate publikohen pas procedimit të gjitha fletëvotimeve. Nga kjo del se rezultatet preliminare nuk mund të jenë të njëjta me rezultatet përfundimtare , andaj edhe ekzistojnë ndryshimet e numrit të votave të theksuara në ankesë. e në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur ankesën e lart përmendur, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 932/2013 më datën 18.11.2013.



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.